



**Engineering progress  
Enhancing lives**

## **Idetë tuaja të shfaqura**

KALEIDO COLOR: Zgjidhje dizajni  
me cilësi të lartë për dritaret tuaja.

Dimensioni i ri i dritareve. Për jetën e sotme.



# Shumëllojshmëria është kudo ditët e sotme. Pse mos të zgjidhni dritaret tuaja?

A i mbani mend videotekat? Të bezdisshme dhe gjithmonë të njëjtët filma. Sot ne paraqesim: Mjaft e thjeshtë dhe me një larmi të pafund filmash, serish dhe dokumentarësh. Dhe kur vjen momenti për të blerë një makinë të re, a jeni të kënaqur vetëm me tre ngjyra? Jo, ju sot mund të zgjidhni nga nuanca të shumta në numër me efekt mat, me shumë shkëlqim dhe perlë.

Për këtë arsye REHAU i ka vënë vetes qëllimin për të krijuar dritare që janë po aq moderne sa jeta jonë. Dritare me teknologjinë më të fundit, por që gjithashtu ju lënë hapësirë ju për idetë, kreativitetin dhe dizajnin tuaj që do ta bëjë jetën më të bukur.





Vendosni theksime me programin tonë të madh të ngjyrave KALEIDO COLOR.

Dimensioni i ri i dritareve.  
Për jetën e sotme.



**Mbi 400  
mundësi  
dizajni**

## Shtëpia juaj. Stili juaj.

Ndërtimi i katër mureve tuaj me lehtësi dhe me stil është gjithmonë çështje zemre. Shpesh anashkalohet fakti se dritaret dhe dyert i japin një pamje të plotë jo vetëm fasadës së një ndërtese, por dhe pjesës së brendshme.

### Fleksibilitet maksimal


Me KALEIDO COLOR, programin gjithëpërfshirës të sipërfaqes dhe ngjyrave nga REHAU, ju mund të vini në zbatim tendencat e momentit të dizajnit dhe stilet që nuk dalin kurrë nga moda, në mënyrë njësoj të thjeshtë dhe të pa vështirësi për shtëpinë tuaj - dhe madje të kombinoni në mënyrë fleksibël pjesën e jashtme dhe të brendshme.

### Mundësi të panumërta

Opsionet e dizajnit ofrohen në një gamë të gjerë që nga imitimi i pamjes së drurit të vërtetë, te sipërfaqet ekskluzive të aluminit, te tonet e bardha klasike që nuk dalin kurrë nga moda për një restaurim elegant - dhe natyrisht me avantazhet bindëse të një dritare plastike.

### Gjuha individuale e dizajnit

Shpesh lind nevoja për dritare të veçanta për shkak të planeve të pazakonta arkitekturore dhe të sofistikuara të dyshemeve. Falë KALEIDO COLOR, dritaret REHAU jo vetëm që duken bukur, por mund të përdoren për të krijuar forma të pazakonta si rrjedhojë e qëndrueshmërisë së tyre.





1

- 1 **Format e qarta** dhe thjeshtësia moderne janë ato që karakterizojnë stilin Bauhaus
- 2 **Kontrast emocionues** me sipërfaqe natyrale
- 3 **Komfort relaksues** me elegancë Skandi
- 4 **E rinovuar në mënyrën e duhur** për ti qëndruar besnik pamjes origjinale
- 5 **Stili mesdhetar** gjithashtu ofrohet për shtëpi pushimi
- 6 **Theksime të jashtëzakonshme** për më shumë individualitet



### Lejoni veten të frymëzoheni

Zbuloni një zgjedhje të vogël idesh për katër muret tuaja në faqet vijuese. Me mbi 400 mundësi dizajniimagjinata juaj nuk njihet kufi.



2



3



4



5



6

# Thjeshtësi moderne


Arkitektura Bauhaus nuk është thjesht duke festuar një rilindje me 100-vjetorin e saj në 2019. Faktori i cili është vendimtar për këtë sukses është stili i drejtpërdrejtë dhe i thjeshtë.



## Elegancë e errët

Kjo thjeshtësi vazhdon në ngjyrat dominuese të dritares: antraciti i lehtë, alumini me të zeze të thellë ose elegant theksojnë standardet e larta të projektimit. Sipërfaqja dhe gama e ngjyrave KALEIDO COLOR ofron mundësi të shumta: nga veshja e strukturuar mat me cilësi të lartë deri tek laminimet e shtresave - gjithashtu me një efekt metalik.

## Zgjedhja tipike e dekorit





#### Agjent stili i besueshëm

Tonet antracitit dhe gri gjithashtu shtojnë një prekje të veçantë në shtëpitë në një stil modern të shtëpive në fshat.



#### 1 Realizimi ekonomik i dizajnëve ekskluzive

Me KALEIDO COVER, sipërfaqja e veshjes prej alumini, dritaret tuaja REHAU bëhen një alternativë më ekonomike e dritareve alumini ose dru-alumini. Sipërfaqja e veshjes mund të lyhet, mbulohet me shtresë pudre ose e anodizuar në më shumë se 170 ngjyra RAL.

#### 2 Pamja tërësore

Pjesët kryesore të ngjyrosura, njësoj si këtu në një antracit elegant sigurojnë një pamje të përhershme cilësi të lartë të dritareve tuaja edhe kur ato janë të hapura.



## Ndjesia dhe pamja e drurit

iluzioni i vërtetë




# Kontrastet natyrale

Materialet me pamje natyrale po bëhen gjithmonë e më shumë popullore. Përdorimi i tyre bëhet veçanërisht mbresëlënës kur ato vendosen në kontrast të lartë - siç është ngjyra e ftohtë e betonit në kombinim me tonet e ngrohta të drurit.

### Pamja dhe ndjesia natyrale

Të paktën aq emocionuese sa kontraste të tilla është KALEIDO WOODDEC, programi ynë i sipërfaqeve për një iluzion të ndjesisë dhe pamjes së drurit të vërtetë. Sipërfaqet mat me struktura të ndërtruara të ndërlukuara japin një pamje dhe ndjesi unike, që është pothuajse e padallueshme nga dritaret prej druri "të vërtetë". Lejo veten të frymëzoheni nga tre opsionet moderne të ngjyrave.



### Pamja prej druri dhe përfitimet nga plastika

Me KALEIDO WOODDEC ju shijoni iluzionin e pamjes dhe ndjesisë së vërtetë të drurit, pa "kujdesin e zakonshëm të drurit":

- Rezistent ndaj kushteve të motit dhe të dritës
- Pa lëmim, lustrim apo larje
- Sipërfaqe të lehta për tu pastruar





© Volker Schrank



**E majtë:** Turner lisi ngjyrë kafe e hapur e kombi-nuar me beton të papërpunuar për një elegancë tërheqëse

**Qendra e pjesës së sipërme:** Shtëpia moderne prej drurie shfaqur në Sheffield lisi ngjyrë betoni si kontrast natyral

**Qendra e pjesës së poshtme:** Sheffield lisi ngjyrë gri e hapur në një fasadë prej druri natyral ngjyra e së cilës është bërë më e ngjashme me ngjyrën e dritares për shkak të kushteve të motit me kalimin e kohës



#### Kombinim fleksibël

Me profilet e dritareve REHAU ju mund të kombinoni në mënyrë fleksibël materialet dhe ngjyrat brenda dhe jashtë sipas dëshirave tuaja.



Turner lisi ngjyrë kafe e hapur




Sheffield lisi ngjyrë betoni



Sheffield lisi ngjyrë gri e hapur

# Rehatia skandinave



Skandinavët janë vazhdimisht në krye të "Raportit Botëror të Lumturisë" të OKB-së. Një arsye vendimtare: rehatia skandinave, e cila gjithashtu shfaqet në dizajnin e katër mureve tuaja.



## Dizajn i thjeshtë

Në detaje kjo do të thotë forma të qarta, ngjyra delikate dhe theksime druri. Çiftimi i duhur: Profilet e dritareve në tonet e ngurta modeste - ose për një shtesë speciale me një sipërfaqe të ashpër. Pavarësisht nëse zgjidhni tonin me ngjyra të brendshme dhe të jashtme, ose i jepni një pamje të re fasadës me një ngjyrë të theksuar, kjo varet nga idetë tuaja individuale.

## Zgjedhja tipike e dekorit




## Kjo është mënyra sesi eleganca skandinave e arrin suksesin

Stili skandinav karakterizohet veçanërisht nga fakti se, duhet të ketë një efekt relaksues. Me qetësinë e tij atij krijon një vend ku nga ana pamore duket sikur çdo gjë është shumë e thjeshtë por në fakt çdo gjë është shumë elegante.




### Përhëndetja rreze dielli

Profilët e dritareve të bardha dhe shumë të ndritshme sjellin shkëlqim dhe ngrohtësi në dhomat tuaja. Dritaret e mëdha e vënë në dukje këtë efekt nga drita shtesë.



Sipërfaqe tradicionale



Sipërfaqe HDF

### E lehtë për tu pastruar

Profilët e zgjedhura të dritareve REHAU janë të disponueshme me një sipërfaqe të lëmuar HDF (Veshje me Rezolucion të Lartë) gjë e cila e bën atë shumë të lehtë për tu mirëmbajtur dhe më pak të prirur ndaj papastërtive. Kështu ju mund të shijoni stilin komod skandinav në relaks maksimal.

# Dritare plastike për çdo shije

Arkitektura konsiderohet një formë arti, e cila duhet të vërë theksin në veçanti individualitetin e ndërtuesve të saj. Fytyra e shtëpisë – dritaret – luajnë një rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Me KALEIDO COLOR dhe dhe mbi 400 mundësi dizajni, ju shfaqni akoma më shumë stilin tuaj individual.

## Rinovuar me stil

Fasadat e vjetra kërkojnë përkujdesje të veçantë. Profilet e bardha me sipërfaqe të ashpër, të kombinuara me armime imitojnë në mënyrë të përkryer pamjen klasike pa pasur nevojë për të njëjtin kujdes intensiv.



## Elegancë që nuk del kurrë nga moda

Një klasike e padiskutueshme, madje dhe për ambientet e jashtme, është dhe do të mbetet ngjyra e bardhë.



### Lehtësia mesdhetare

Sigurisht që në Toskana moti me siguri është më i mirë. Por edhe në shtëpi nuk keni pse të merreni me stilin mesdhetare. Për shembull qëndroni besnik stilit me KALEIDO FOIL me sipërfaqet e ashpra me tonet klasike të drurit ose ato moderne të sjella në të bardhën klasike.




### Theksime mbresëlënëse

Për të gjithë që e vlerësojnë të veçantën. Nëse doni ti jepni theksime interesante një arkitekture të thjeshtë me ngjyrat me në modë, me KALEIDO COLOR do të gjeni ngjyrën e duhur nga të gjitha ngjyrat RAL.

# Teknologji e cilësisë së lartë, rezultatet më të mira


Programet e ndryshme për sipërfaqet nga KALEIDO COLOR ju ofrojnë ju çdo mundësi për të realizuar dritaret tuaja siç i kishit imagjinuar:



## KALEIDO COVER


Veshjet prej alumini mundësojnë, që pamja e profileve të aluminit të kombinohet me avantazhet teknike të dritareve plastike.

KALEIDO COVER përshtatet në mënyrë të përkryer në formën e dhomave të profilit të dritares dhe ngjitet fortë me të. Sipërfaqja e veshjes mund të lyhet me llak, të mbulohet me shtresë pudre ose anodizohet dhe njëkohësisht është robust dhe e qëndrueshme në mot të ligë.




## KALEIDO WOODDEC

Iluzion i vërtetë: pamje dhe ndjesi bindëse të drurit me një shtresë të sipërme mat dhe një zbukurim me reliev veçanërisht të thellë për një pamje akoma më të vërtetë. Për shembull, dritaret plastike janë pothuajse të padallueshme nga dritaret prej druri - mirëmbajtja minimale dhe jetëgjatësia maksimale e përfshirë.



## KALEIDO FOIL

Procesi standard i vërtetuar me shtresën dekorative PVC dhe dy shtresat e saj: shtresa bazë siguron ngjyrën e dëshiruar dhe shtresa e sipërme transparente mbron nga zbehja dhe ndikimet e tjera mjedisore. Dekoret prej laminati nga REHAU vendosen butësisht në profilin e dritares nga një proces i veçantë që kryhet nga makina me kapacitet të lartë. Pra, ato janë të forta dhe të lidhura me profilin për një kohë të vazhdueshme.



## KALEIDO PAINT

Mundësi të pakufizuara: boja klasike aplikohet në disa shtresa, sipas dëshirës me një shtresë të sipërme me shkëlqim ose mat në pothuajse të gjitha ngjyrat RAL. Lyerjet që japin forma japin efekte vizuale të veçanta.

### REHAU ka hedhur hapa të mëdhenj në botën e bojërave



Përfitoni nga niveli më i lartë i lyerjes me bojë përmes viteve përvojë në industrinë e automobilitave, ku REHAU lyen me bojë pjesët e automjeteve në më shumë se 500 ngjyra.



### Zgjedhje shumë e mirë ngjyrash

Të gjitha programet e sipërfaqeve ju ofrojnë një gamë të madhe ngjyrash. Një vështrim i duhur i përgjithshëm mund të gjendet në faqen tonë ose tek instaluesi juaj.

Të gjitha materialet dhe sipërfaqet u nënshtrohen standardeve më rigorozë të cilësisë. Analizat e sakta dhe testet afatgjata me ngarkesa më të larta sigurojnë që ju të shijoni dritaret tuaja REHAU për një kohë të gjatë.



#### **Pamja tërësore**

Pjesët kryesore të lyera sigurojnë një pamje të përhershme me cilësi të lartë të dritareve tuaja. Profilet janë të ngjyrosura tërësisht, në mënyrë që të arrihet një pamje e përgjithshme shumë harmonike, veçanërisht kur elementet e dritares janë të hapura. Në varësi të modelit dhe ngjyrës së sipërfaqes, përdoren pjesët kryesore në antracit, kafe, të bardhë ose ngjyrë karamel.

# Shtesa inteligjente

Që dritaret tona duken bukur, ju këtë e dini tashmë. Përveç vlerave të jashtme, ata përsëri qëllonë në shenjë me shumë karakteristika të tjera që me të vërtetë i bëjnë dritaret e tua në dritaret e momentit.



## Mbrojtje nga vjedhjet

Moduli i alarmit REHAU Smart Guard, i cili mund të integrohet brenda kornizës, zbulon vjedhësit dhe i pengon ato në mënyrë aktive para se të mund të dëmtohen. Në rast urgjence, alarmi kryesor aktivizohet nëpërmjet radios. Me lidhje opsionale Smart Home për programe individuale alarmi.



## Ajrosje inteligjente

GENEO INOVENT inteligjent: Ajrosni dritaret ndërkohë që janë të mbyllura. Sistemi i integruar plotësisht siguron një klimë të rehatshme me ajër të shëndetshëm, më shumë paqe dhe siguri. I shoqëruar me qendrën e kontrollit dhe sensorët Smart Home, GENEO INOVENT inteligjent kryen ajrosje tërësore automatikisht për 24 orë.







#### Mbrojtje e certifikuar nga rënia

Ballkoni SKYFORCE me xham francez për dritaret nga tavani në tokë është zgjidhja që kombinon sigurinë e certifikuar me tërheqjen vizuale. Ai mbështet linjat e pastra të fasadave moderne dhe mund të montohet pa vida që duken. Sigurisht, sipas parimit të KALEIDO COLOR SKYFORCE është i disponueshëm me sipërfaqe të shumta adonizuese dhe mbuluese.

#### Qasje pa pengesa

Me pragun RAUCERO prej 0 mm, kalimi nga ambientet e brendshme në ato të jashtme mund të bëhet lehtësisht pa asnjë vështirësi. Sistemi i integruar i kullimit si dhe lehtësia gjatë pastrimit janë po aq bindëse sa pamja e tyre tërheqëse dhe e fshehtë.



#### Doreza elegante të dritares

Pamja e thjeshtë e dorezave të dritares LINEA harmonizohet në mënyrë të përsosur me linjat e pastra të dritareve moderne. Dorezat janë të disponueshme në ngjyra të ndryshme të anodizuara dhe RAL - madje edhe me sipërfaqe të lëmuara. Siguria shtesë në dritaret jepet nga teknologjia e integruar Secustik® me një mekanizëm të dukshëm bllokimi që e bën të vështirë lëvizjen e dritares nga jashtë pa një autorizim.

**Vendosni shumë  
mundësi.**

**Dimensioni i ri i dritareve.  
Për jetën e sotme.**





REHAU Dooel Skopje  
Boris Trajkovski 7 bb  
1000 Skopje, Macedonia  
Tel +389 2 2402 670  
Fax. +389 2 2403444  
E-Mail: [skopje@rehau.com](mailto:skopje@rehau.com)  
Web: [www.rehau.mk](http://www.rehau.mk)

Rezervohet e drejta për ndryshime teknike.

Lutemi, vini re se informacionet përkatëse teknike të produktit mund të gjenden në faqen [www.rehau.com/ti](http://www.rehau.com/ti).

Informacione të tjera mund të gjeni në faqen [www.rehau.al/dizajnidritareve](http://www.rehau.al/dizajnidritareve)

Ju mund të përfitoni nga mbi 400 mundësi dizajni me KALEIDO COLOR:

REHAU Prishtina  
Eqrem Çabej 13  
10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 (0) 38/ 222 368  
Fax: +383 (0) 38/ 222 370  
Mobil +383 44 760 184  
E-mail: [prishtina@rehau.com](mailto:prishtina@rehau.com)  
Web: [www.rehau.al](http://www.rehau.al)

REHAU Tirana  
Zyra e Perfaqesise REHAU Tiranë  
Autostrada Tirane-Durres Km 1  
1033 Tirana/Albania  
Tel / Fax. ++355 4 4500 610  
Mobil ++355 6820 22541  
E-Mail: [tirana@rehau.com](mailto:tirana@rehau.com)  
Web: [www.rehau.al](http://www.rehau.al)

700062 AL 10.2019